




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT
PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke theksuar se, përveç rolit rregullator dhe asistues të ERRU-së, është e nevojshme që çështjet rregullatore dhe të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të jenë në vëmendje të vazhdueshme edhe të institucioneve përgjegjëse të linjës, AKUK-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e aksionerëve të shoqërive;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm forcimin e stabilitetit menaxherial në shoqëritë UK, si një faktor që kontribuon në përmirësimin gradual të performancës dhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve;

Duke theksuar faktin se sfidat e sektorit UK, si dhe reforma e ndërmarrë nga qeveria në këtë sektor, e bëjnë të domosdoshëm miratimin sa më parë të ligjit të ri, duke i dhënë ERRU-së kompetencat e nevojshme të rregullatorit të sektorit, si dhe duke rritur pavarësinë e tij institucionale;

Shqyrtoi veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit për vitin 2025 dhe vlerëson:

Punën e bërë për miratimin dhe zbatimin e Planit të Biznesit 5-vjeçar për shoqëritë rajonale, si një instrument që krijon lidhje të drejtpërdrejta ndërmjet strukturës tarifore, objektivave të performancës, programeve të investimeve dhe menaxhimit të aseteve dhe në të njëjtën kohë bën të mundur të analizohen tarifat në kuadër të një plani të integruar zhvillimi afatmesëm, duke forcuar përgjegjshmërinë e operatorëve dhe transparencën në përdorimin e burimeve financiare.

Punën e bërë për rekomandimet konkrete drejtuar shoqërive UK, për kryerjen e analizave të detajuara të eficiencës së energjisë, identifikimin e pajisjeve dhe sistemeve me konsum të lartë, si dhe ndërmarrjen e masave për uljen e konsumit, përfshirë investimet në pajisje me eficiencë të lartë

dhe përdorimin e burimeve alternative të rinovueshme, dhe inkurajon ERRU-në të vijojë të kërkojë rritjen e eficiencës së energjisë nga ana e shoqërive UK, pasi kostoja e energjisë elektrike mbetet një nga zërat kryesorë të kostove operative.

Punën e bërë për zbatimin e metodologjisë së tarifave dhe inkurajon ERRU-në që përgjatë vitit 2026, ku kemi për herë të parë shoqëri të cilave u mbaron periudha rregullatore, të aplikojë me rigorozitet “Pikët e vlerësimit të performancës” kur shoqëria UK vjen për herë të dytë për aplikim tarifor.

Punën e bërë për masat e marra që faqja e ERRU-së në internet apo edhe faqet e ERRU-së në rrjetet sociale të kenë në fokus konsumatorin, duke vendosur në faqen kryesore linkun ku konsumatorët mund të paraqesin ankesë në ERRU ose publikimet në postimet në rrjetet sociale të institucionit që lidhen me konsumatorin. Të gjitha këto masa nga njëra anë ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe nga ana tjetër forcojnë besimin e konsumatorit te rregullatori.

Punën e bërë si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), në raportimet periodike dhe në përgatitjet paraprake të Planit Kombëtar të Përafrimit me *acquis-n* e BE-së 2026–2027.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Enti Rregullator i Ujit për vitin 2026 në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të kërkojë një planifikim të dedikuar financiar për investime të strukturuar dhe sistematike për instalimin e ujëmatësve në prodhim dhe në të njëjtën kohë të inkurajojë shoqëritë UK për aplikimin e tarifave me blloqe për të bërë të mundur uljen e konsumit mbi normë të ujit nga konsumatorët, veçanërisht në zonat rurale dhe konsumatorët jofamiljarë.

2. Me gjithë trendin e ngadaltë pozitiv gjatë vitit 2025, duke pasur parasysh që Uji Pa të Ardhura vijon të mbetet në nivele të larta, të mos kufizohet vetëm në rekomandime drejtuar shoqërive UK për rritjen e matjes në burim dhe konsum, përmirësimin e faturimit, evidentimin e humbjeve reale dhe administrative, por të caktojë objektiva dhe afate konkrete për përmbushjen e tyre nga shoqëritë UK, veçanërisht kur bëhet fjalë për pajisjen e konsumatorëve 100% me matës, si një kusht i domosdoshëm për monitorimin e realizimit të objektivit të Ujit pa të Ardhura. Brenda 3-mujorit të tretë të vitit të informojë me shkrim Kuvendin e Shqipërisë për rekomandimet që u ka dhënë shoqërive UK.

3. Duke qenë se në 4 vjetët e fundit treguesi i performancës “Ankesat e klientëve”, trajtuar në ERRU, nuk është përmirësuar, duhet të rritet angazhimi si rregullator në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në koordinim me AKUK-në për të adresuar me procedura të përmirësuar dhe me ndjekje rigorozë të procesit të shqyrtimit të ankesave. Në frymë dhe me objektivin për të forcuar dhe unifikuar procedurat e brendshme të trajtimit të ankesave, të kërkohet të raportohen zgjidhje konkrete dhe në kohë nga shoqëritë UK për konsumatorët që adresojnë ankesat. Rekomandohet që ERRU-ja të mundësojë një raportim 6-mujor në Kuvendin e Shqipërisë, si një raport analitik i trajtimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit dhe shoqërive UK.

4. ERRU-ja së bashku me AKUK-në të angazhohen për të vënë në përdorim Sistemin e Integruar të Informacionit të Performancës (IPIS), pasi saktësia dhe unifikimi i të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK është shumë i rëndësishëm për ERRU-në për rritjen e besueshmërisë dhe transparencën ndaj publikut, si dhe për MIE/AKUK-në shërben si një bazë e fortë për planifikimin e politikave të zhvillimit të këtij sektori në funksion të qytetarëve.

5. ERRU-në, në bashkëpunim me AKUK-në, duhet të ndërmarrë hapa dhe propozime konkrete për promovimin e sistemeve të monitorimit me kamera dhe mbrojtjes perimetrale inteligjente, implementimi i të cilave sjell përmirësime konkrete të treguesve përkatës të performancës të shoqërive rajonale UK.

6. Duke qenë se pas riorganizimit dhe rajonalizimit të sektorit UK fokusi tashmë është zhvendosur drejt forcimit të qëndrueshmërisë financiare, përmirësimit të performancës dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët, ERRU-ja të fokusohet në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe metodologjik në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë financiare dhe eficiencës së sektorit UK, si

dhe në thellimin e monitorimit të performancës së shoqërive UK, me fokus përmbushjen e objektivave të performancës, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe rritjen e transparencës.

7. T'i kushtojë vëmendje të veçantë mbështetjes së zbatimit të planeve 5-vjeçare të biznesit, si instrument strategjik për planifikimin afatmesëm teknik dhe financiar të shoqërive UK, konsolidimit institucional të shoqërive UK dhe përmirësimit të menaxhimit të aseteve në funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë të sektorit.

8. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të ketë në fokus të aktivitetit të tij konsolidimin e sistemit të raportimit dhe analizës së të dhënave sektoriale për mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

9. Të vijojë të japë kontributin e tij në procesin e integritit evropian përmes harmonizimit gradual të praktikave rregullatore me standardet e Bashkimit Evropian.

10. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës të Kuvendit, në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

Miraturar në datën 16.7.2026